

V E N D I M
Nr. 202, datë 22.4.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE DHE DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 437, datë 3.9.1993 "Për pagat e punonjësve të tatimeve dhe doganave", bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve,

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin

Ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore 51 600 lekë

b. Në pikën 2, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Zëvendës drejtor i Doganave

Zëvendës drejtor i Tatimeve 36 850 lekë

c. Në pikën 3, niveli më i ulët i pagës bëhet 7 700 lekë në muaj kurse niveli më i lartë (kryetar dege, drejtor drejtorie) bëhet 20 350 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit për vitin 1999.

3. Ky vendim i shtrin efektet e tij financiare nga data 1.5.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko